



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

**“CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONEVE
ZGJEDHORE TË ZAZ-SË NR. 88, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETARIN E
BASHKISË HIMARË, TË 4 GUSHT 2024”**

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 244, datë 05.07.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, caktoi datën 4 Gusht 2024, si ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë.

Referuar nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton me vendim masën e shpërblimit për punën që kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

Zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, diktojnë ngritje të Komisioneve Zgjedhore të të gjitha niveleve për ZAZ nr. 88, Bashkia Himarë, si anëtarë të KZAZ-ve, të Qendrave të Votimit dhe të Grupeve të Numërimit të Votave.

KZAZ nr. 88 ka në juridiksionin e saj 36 qendra votimi. Anëtarët e KZAZ-së nr. 88, referuar edhe masës se shpërblimit për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore të datës 14 maj



2023, është parashikuar të përfitojnë shpërblim në përputhje me ngarkesën e komisioneve të qendrave të votimit dhe proceset e punës që do të kryhen përgjatë kësaj periudhe.

Komisioneri, për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, vlerëson kohëzgjatjen e angazhimit, detyrat, përgjegjësitë dhe ngarkesën e punës, sipas nivelit të administratës zgjedhore dhe funksionit përkatës.

Është vlerësuar se angazhimi i kësaj KZAZ-je në raport me periudhën, kushtet dhe volumin e punës korrespondon me ngarkesë të plote por për një periudhe me shkurtër kohore referuar me shpërblimin e anëtarëve të KZAZ-së, me zgjedhjet pararendëse. Ndërsa masa e shpërblimit për anëtarët e GNV-se dhe KQV-se është parashikuar të bëhet për të njëjtën ngarkesë dhe periudhë kohore të angazhimit të tyre si në zgjedhjet pararendëse.

Përsa më sipër propozohet që anëtarët e anëtarët e komisioneve zgjedhore, të Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve nr. 88, që do të angazhohen në zgjedhjet e pjesshme, për Kryetarin e Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, të shpërblehen si më poshtë:

- Kryetari dhe zv.kryetari i KZAZ-së, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- Sekretari i KZAZ-së, në masën 47.500 (dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë.
- Anëtar i KZAZ-së, në masën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë.
- Kryetari i KQV-së, në masën 4.000 (katër mijë) lekë.
- Anëtar dhe Sekretari i KQV-së, në masën 3.500 (tre mijë e pesëqind) lekë.
- Anëtar i GNV-së, në masën 6.000 (gjashtë mijë) lekë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

(Në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA

Erion Meta - Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Enkeleon TOPULLI - Drejtorja e Menaxhimit të Buxhetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: .7.2024

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

**CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONEVE
ZGJEDHORE TË ZAZ-SË NR. 88, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETARIN E
BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje, të nenit 19, pikat 1 shkronja “n” e 2, nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S:

- Shpërblimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore, të Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve nr. 88, të angazhuara në zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, si më poshtë:
 - Kryetari dhe zv.kryetari i KZAZ-së, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
 - Sekretari i KZAZ-së, në masën 47.500 (dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë.
 - Anëtari i KZAZ-së, në masën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë.
 - Kryetari i KQV-së, në masën 4.000 (katër mijë) lekë.
 - Anëtari dhe Sekretari i KQV-së, në masën 3.500 (tre mijë e pesëqind) lekë.
 - Anëtari i GNV-së, në masën 6.000 (gjashtë mijë) lekë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 3 vjet
S.Bregasi _____
E.Dushallari _____
E.Meta _____
M.Çelmeta _____

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: .7.2024 Nr:
Ora:



“Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të ZAZ-së nr. 88, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”